



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:276045

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06632868

P.nr.98//24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale kundër të pandehurit B.K., nga, për shkak të veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*”, nga neni 185 par. 1 lidhur me par 1.4 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm nën shenjen PP/II.nr.2186/2023 të datës 07.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, të mbajtur me datën 03.12.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, përfaqësuesi i të dëmtuarit J.K., av. Burhan Shabanaj nga Peja, sipas autorizimit, i pandehuri B.K, si dhe mbrojtësi i tij av.Haxhi Beqiraj, nga Deçani, sipas autorizimit, me datën 06.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 20.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B.K, i lindur më datë në, me vendbanim në lagjen “....” në, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., me numër tel, i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Me datë 29.10.2023 rreth orës 12:00 në lagjen ..., në, përkatësisht pranë shtëpisë së të dëmtuarit, me dashje i shkakton lëndime trupore me pasojë të përkohshme të shëndetit të

dëmtuarit J.K., në atë mënyrë që, pas një mosmarrëveshje që kishin pasur i pandehuri me të dëmtuarin lidhur me një mur që i dëmtuari e kishte ndërtuar në bjeshkë, ditën kritike në kohën e lartcekur, tek shtëpia e të dëmtuarit vjen i pandehuri duke e thirr që të dal jashtë, e sapo del i dëmtuari, i pandehuri menjëherë e sulmon duke e goditur me grushta në kokë dhe pjesë të tjera të trupit dhe i njëjti largohet nga vendi i ngjarjes, ku të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme të shëndetit.

-Me çka ka kryer veprën penale **“Lëndim i lehtë trupor”** nga neni 185 par. 1 lidhur me par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 dhe nenit 185 par. 1 lidhur me par. 1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449, 462, të njëjtin e:

G J Y K O N

I. Me **DËNIM ME GJOBË**, në shumë prej njëmijë (1000) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

II. Nëse i pandehuri, dështon, refuzon apo nuk dëshiron që ta paguajnë dënimin e shqiptuar me gjobë si në pikën I, të këtij aktgjykimi, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim duke i llogaritur shumë prej njëzetë (20) euro, për një ditë burgimi.

III. Obligohet i pandehuri, që gjykatës ti paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, si dhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej njëzetë (20) euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. I dëmtuari J.K., me vendbanim në lagjen ..., Komuna e, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datën 07.12.2024, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II.nr.2186/2023, kundër të pandehurit B.K, nga, me vendbanim në lagjen "....." në, për shkak të veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*”, nga neni 185 par. 1 lidhur me par 1.4 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 03.12.2024, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, përfaqësuesi i të dëmtuarit J.K., av. Burhan Shabanaj nga Peja, sipas autorizimit, i pandehuri B.K, si dhe mbrojtësi i tij av. Haxhi Beqiraj nga Deçani, sipas autorizimit.

Në këtë seancë, gjykata në pajtim me nenin 241 par.1 të KPPRK-së e ka udhëzuar të pandehurin B.K, për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë. Para leximit të aktakuzës, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë. Më pas gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për fajësinë apo pafajësinë.

I pandehuri B.K, i ftuar që të deklarohej për fajësinë apo pafajësinë, ka deklaruar së e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, respektivisht për veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*”, nga neni 185 par. 1 lidhur me par 1.4 të KPRK-së.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit B.K, gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*. Me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur është pajtuar edhe përfaqësuesi i të dëmtuarit J. K., av. Burhan Shabanaj, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*, po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit B.K, av. Haxhi Beqiraj i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti është bere në konsultim të mjaftueshëm me mua, duke i sqaruar benefitet dhe*

privilegjet e pranimit të fajësisë, i njëjti këtë pranim fajësie e bene me vullnetin e tij të lirë dhe se i propozoj gjykatës që të njëjtit t'ia aprovojë.

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vlerësuar pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të pandehurit, në bazë të nenin 242 par. 2 nën par. 2.1 e deri 2.4 të KPPRK-së, vlerësoi dhe gjeti së i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së këtë pranim të fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, dhe pasi që i janë komunikuar të gjitha të drejtat sipas KPPRK-së, së një pranim i tillë i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes si dhe në materialet e dorëzuara nga Prokuroria siç janë: *Raporti i oficerit H.GJ. #4157 me datë 30.10.2023; Deklarata e të dëmtuarit J.K. me datë 30.10.2023; Deklarata e dëshmitarit Q. Sh. me datë 31.10.2023; Raporti i spitalit me nr. 17183 me datë 30.10.2023; Kërkesë për ndalim; Urdhër Departamentit të Mjekësisë Ligjore me datë 06.11.2023; Akt-Ekspertimi i Mjekësisë Ligjore me datë 16.11.2023,* dhe së aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që në bazë të nenit 242 par. 6 të KPPK-së, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se i pandehuri ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tij të plotë, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit konform nenit 356 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për një seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën duke i ftuar palët që të deklarohen në fjalën e tyre lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit në kuptim të rrethanave rënduese i propozoj gjykatës të marr parasysh ndonjë dënim eventual të të pandehurit ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

Përfaqësuesi i të dëmtuarit J.K., av. Burhan Shabanaj, ka deklaruar se: *me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit përveç që i bashkëngjitem PSH në fjalën e tij, shtojë që gjykata të marr parasysh edhe një çështje tjetër penale që po ashtu i dëmtuari J.K. ka cilësinë e palës së dëmtuar ndërsa i akuzuari B.K cilësinë e palës së akuzuar sipas akuzës PP/II.nr.2368/23 e si çështje është duke u shqyrtuar në Gjykatën Themelore në Pejë- dega Deçan nën shenjen e P.nr.294/23, gjithashtu parashtrijmë kërkesë pasurore juridike.*

Mbrojtësi i të pandehurit B.K, av.Haxhi Beqiraj, ka deklaruar se: *i propozojmë gjykatës që në rastin e matjes së dënimit, si rrethanë lehtësuese të marr pranimin e fajësisë, të kaluarën e pastër kriminale, shprehjen e keqardhjes, kërkim faljen si dhe premtimin që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale.*

I pandehuri B.K, ka deklaruar se: *i kam kërkuar falje të dëmtuarit, shpreh keqardhje për veprën penale të kryer, që nga ajo ditë nuk kam pasur ndonjë konflikt apo mosmarrëveshje me të dëmtuarin, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të tjera, nuk kam qene i dënuar me pare për vepra të tjera penale.*

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Sa i përket vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ka gjetur si rrethana lehtësuese për të pandehurin B.K, faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga ana e gjykatës, pendimin e shprehur nga ana e të njëjtit si dhe faktin së të dëmtuarit i ka kërkuar falje ndërsa në rastin konkret për të pandehurin nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese por vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale të kryer nga i pandehuri, ndërkaq sa i përket propozimit të përfaqësuesit të të dëmtuarit J.K., av. Burhan Shabanaj, që ndaj të pandehurit të mirët si rrethanë rënduese fakti që i njëjti ka një çështje tjetër penale me palën e dëmtuar, gjykata një rrethanë të tillë nuk mund t’a marrë si rrethanë rënduese për faktin se gjykata nuk mund të vlerësoi si rrethanë rënduese një çështje penale për të cilën nuk ka aktgjykim të formës së prerë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Andaj, gjykata të njëjtit i shqiptoi dënim me gjobë si në pikën I, të ketij dispozitivi të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 46, 47, 48, dhe 49 e lidhur me nenin 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së. Përderisa për veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, përcaktohet dënueshmëria me dënim me gjobë ose me dënim me burgim deri në tri (3) vite, përkatësisht “*Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: 1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet*”, gjykata ka shqiptuar dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguajnë dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari J.K., nga, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.98/24, me datën 20.12.2024.

Zyrtarja Ligjore:

Gjyqtarja e vetme gjykuese:

Blerinda Laiq

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.